



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr.2004/35

PËR LOJËRAT E FATIT

Kuvendi i Kosovës

Duke marrë parasysh Rregulloren e UNMIK-ut, nr.2001/9 të 15 majit 2001, mbi Kornizen Kushtetuese të vetëqeverisjes së përkohshme në Kosovë, veçanërisht Kreun 5.1(a), 9.1.1, 9.1.26 (a) dhe,

Rregulloren e UNMIK-ut, nr.2001/19, të 13 shtatorit 2001, mbi degën egzekutive të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë, veçanërisht nenin 1.6,

Me qëllim të parandalimit të krimit, mbrojtjes dhe sigurimit të popullatës kundër mashtrimit, lajthimit dhe gënjimit që dalin nga aktivitetet joligjore të lidhura me lojërat e fatit në Kosovë,

Miraton:

LIGJIN PËR LOJËRAT E FATIT

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

1.1. Me këtë ligj përcaktohen dhe rregullohen kushtet, mënyra dhe subjektet që organizojnë dhe ushtrojnë lojërat e fatit, llojet e lojërave të fatit, parimet themelore të rregullave për sistemimin e të hyrave nga lojërat e fatit, themelimi, pozita juridike, qeverisja dhe menaxhimi i Lotarisë së Kosovës, kompensimi për ushtrimin e lojërave të fatit, mbikëqyrja, dënimet kundravajtëse si dhe çështje të tjera me rëndësi për lojërat e fatit në Kosovë.

1.2. Ushtrimi i lojërave të fatit në territorin e Kosovës realizohet nëpërmjet Lotarisë së Kosovës dhe të subjekteve të tjera juridike të regjistruara dhe të licencuara për ushtrimin e lojërave të fatit.

Neni 2

Lojërat e fatit, sipas këtij ligji konsiderohen lojërat më të cilat pjesëmarrësve u jepet mundësia e fitimit në para, sende apo të drejta me atë që rezultati i fundit i lojës nuk varet nga dija apo mjeshtria e pjesëmarrësit në lojë, por nga rasti apo situata e pasigurtë.

Neni 3

3.1. Lojërat e fatit janë:

- a. lojëra klasike të fatit
- b. lojëra të veçanta të fatit.
- c. lojërat e tjera elektronike

3.2. Lojërat klasike të fatit janë lojëra në të cilat merr pjesë një numër më i madh i pjesëmarrësve me synim për të qenë fitues të vetëm, apo të pjesërishëm të fitimit më parë të definuar nga fondi i fitimeve.

3.3. Lojërat e veçanta të fatit janë lojëra në të cilat individi i kundërvehet organizuesit dhe pret fitim, varësisht nga lartësia e depozitit të vet dhe e rregullave të lojës.

3.4. Lojërat elektronike janë lojëra të fatit që zhvillohen përmes internetit dhe telefonisë mobile. Organizimi dhe ushtrimi i lojërave elektronike do të rregullohet më akt të veçantë juridik.

3.5. Lojërat klasike të fatit janë lojëra në të cilat më parë përcaktohet lartësia e fondit të fitimeve siç vijon:

- a. lotaria, (e mallit, monetare, monetare–e mallit, ekspres lotaria dhe instant lotaria);
- b. loto, keno dhe varianta të tjera të saj;
- c. prognoza sportive - toto;
- d. lojërat në sistemin e automatit;
- e. tombolla TV- bingo;
- f. tombolla - bingo në lokale të mbyllura, si dhe
- g. lojëra të ngjashme të fatit me sistem të tërheqjes.

3.6. Lojërat e veçanta të fatit, janë lojëra në të cilat, më parë nuk përcaktohet fondi i fitimeve, siç janë:

1. lojërat në kasino,
2. lojërat në automate në klube të veçanta dhe me mekanizma të tjerë me rol të shumëfishtë dhe me fitime, siç është (multiplejeri) dhe
3. lidhja me kusht për rezultate dhe ngjarje të ndryshme – basti;

Neni 4

Pjesëmarrës në lojën e fatit është personi që i plotëson kushtet për pjesëmarrje në lojëra të fatit të caktuara, gjë që dëshmon me fletëz të veçantë, apo me vërtetim për pagesë varësisht nga tipi i lojës në të cilën merr pjesë, si dhe me rregullat e lojës së caktuar.

Neni 5

Fondi i fitimeve është pjesa e masës së përgjithshme të paguar në xhiron e caktuar të lojës së fatit, përkatësisht të vlerës së emisionit të tiketave që paguhen në lojërat e fatit në pajtim me këtë ligj dhe me rregullat e lojës.

Neni 6

6.1. Lojërat e fatit nga neni 3 i këtij ligji, organizohen dhe ushtrohen në bazë të këtij ligji dhe të lejës nga MEF-i.

6.2. Lojërat klasike të fatit organizohen vetëm nga Lotaria e Kosovës sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj – përveç lojës së fatit siç është Tombolla – Bingo në lokale të mbyllura të cilën mund ta organizojnë edhe subjektet e tjera juridike në përshtatje me lejën e organit kompetent, por vetëm në lokale të mbyllura, e cila nuk mund të transmetohet publikisht.

6.3. Subjektet e tjera juridike nga paragrafi 6.2 i këtij neni konsiderohen Federata e Sporteve.

Neni 7

Lojërat e veçanta të fatit mund t'i organizojë dhe t'i ushtrojë Lotaria e Kosovës sipas kushteve të përcaktuara me ligj si dhe subjektet ekonomike të regjistruara vetëm për lojën e caktuar të fatit të përcaktuara me këtë ligj dhe në bazë të lejës së MEF-it. .

Neni 8

8.1. Për pagesën e fitimeve nga lojërat klasike të fatit, të cilat i organizon Lotaria e Kosovës, garanton Qeveria e Kosovës.

8.2. Për pagesën e fitimeve nga lojërat e veçanta të fatit përgjigjet dhe garanton organizuesi i tyre me pasurinë që e disponon .

Neni 9

9.1. Lojërat zbavitëse siç janë lojërat në kalkulator, simulator, automatë, flipër, biliard si dhe lojërat që vëhen në lëvizje nëpërmjet parave metalike apo të zhetonave në të cilat lojëtarit nuk mund të fitojë para, sende apo të drejta, nuk janë lojëra të fatit sipas këtij ligji.

9.2. Konkursët shpërblyese dhe lojërat e shpërblyese që i organizon subjekti juridik me qëllim propagandistik nuk janë lojëra të fatit në pajtim me këtë ligj dhe të njëjtat, mund të organizohen me kusht që pjesëmarrja në lojë të mos inkasohet, veçanërisht që shpërblimi të paguhet në prodhime apo shërbime dhe që rregullat e lojës në bazë të lejës së Ministrisë për Ekonomi dhe Financa të shpallen në shtypin ditor.

Neni 10

Lojërat korespondente që themelohen në progresion gjeometrik, me korespondencë dhe në pagesa të shumave të caktuara si dhe të gjitha lojërat e quajtura piramidore, në pajtim me këtë ligj, nuk janë lojëra të fatit dhe si të tilla janë të ndaluara.

Neni 11

Lojërat e fatit, nuk lejohen të ushtrohen në zona të lira.

II LOTARIA E KOSOVËS

Neni 12

12.1. Lotaria e Kosovës është subjekt juridik- publik me interes të veçantë për Kosovën dhe si e tillë është e regjistruar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, si subjekt juridik publik për organizimin dhe ushtrimin e lojërave të fatit.

12.2. Qeveria merr përgjegjësi për të gjitha detyrimet e themeluesit të Lotarisë së Kosovës.

12.3. Veprimtaria e Lotarisë së Kosovës është ushtrimi i lojërave të fatit dhe i lojërave për zbavitje–në pajtim më këtë ligj dhe për ushtrimin e të cilave Lotarisë së Kosovës nuk i kërkohet leje e veçantë nga Ministria për Ekonomi dhe Financa.

Neni 13

13.1. Organi drejtues i Lotarisë së Kosovës është Bordi drejtues, i cili i ka 5 anëtarë.

13.2. Anëtarët e Bordit drejtues i propozon Qeveria dhe i emëron Kuvendi me mandat 4 (katër) vjeçar.

13.3. Anëtarët e Bordit nuk mund të jenë:

- a). zyrtar të lartë të Qeverisë,
- b). udhëheqës të lartë të Partive Politike,
- c). përsoneat që kanë bashkëshortin-en ose anëtarët e familjes së ngushtë në funksione të larta në Lotarinë e Kosovës.

13.4. Anëtarët e Bordit Drejtues do të kenë statusin e shërbyesit civil në momentin e emërimit.

13.5 Bordi Drejtues do të kryesohet nga kryetari i cili zgjidhet gjatë procesit të nominimit sipas paragrafit 2 të këtij neni.

13.6 Kuvendi mund të liroj nga puna një anëtar të Bordit para se t'i skandoi afati i mandatit nëse:

- a). ofron dorëheqjen,
- b). i keqpërdor të drejtat e tij dhe
- c). dënohet për kundërvajtje sipas këtij ligji apo ligjeve tjera.

13.7. Kryetari i Bordit Drejtues të Lotarisë së Kosovës, funksionet e veta i ushtron në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të Lotarisë së Kosovës, funksionet e të cilit më afër përcaktohen me Statutin e Lotarisë së Kosovës.

Neni 14

14.1. Lotaria e Kosovës e ka Statutin me të cilin veçanërisht përcakton dhe rregullon:

- a. Firmën dhe selinë;
- b. Veprimtarinë;

- c. Kapitalin themelor;
- d. Sasinë, disponimin dhe tërheqjen e depoziteve nga kapitali themelor;
- e. Ndarjen e fitimeve dhe sistemimin e të ardhurave;
- f. Bartjen e rreziqeve dhe të humbjeve;
- g. Administrimin, caktimin, shkarkimin, autorizimin, përgjegjësinë dhe pagimin e punëtorëve të caktuar;
- h. Organizimin e brendshëm;
- i. Çështjet statutore;
- j. Kohëzgjatjen dhe mbarimin e veprimtarisë si dhe çështjet e tjera të cilat dalin nga ligji për ushtrimin e veprimtarisë së Lotarisë.

14.2. Statutin e Lotarisë së Kosovës e propozon Bordi drejtues i Lotarisë së Kosovës, ndërsa Ministri për Financa dhe Ekonomi jep pëlqimin të cilin e miraton Qeveria e Kosovës.

Neni 15

Bordi drejtues i Lotarisë së Kosovës:

- a. shqyrton dhe miraton Planin afarist vjetor,
- b. shqyrton raportin afarist të vitit paraprak, jep mendime dhe propozime në të dhe bashkë me to ia dërgon Ministrisë për Ekonomi dhe Financa për shqyrtim dhe vendosje,
- c. në rastin e parashtrimit të raportit afarist nga viti paraprak dhe të Planit afarist për vitin rrjedhës, i jep propozim MEF-it, për përgatitjen e vendimit për sistemimin e mjeteve të realizuara,
- d. vendos për lëshimin dhe publikimin e tiketave,
- e. miraton rregullat e lojërave të fatit,
- f. jep iniciativa për miratim, ndryshim apo plotësim të dispozitave nga fushëveprimtaria e lojërave të fatit, të cilat ia paraqet MEF-it,
- g. MEF-it i propozon për të dhënë pëlqim dhe verifikim për kontratat për ushtrimin e përbashkët të lojërave të fatit me lotaritë e vendeve të tjera që ushtrojnë lojërat e fatit apo me organizatat e specializuara.

Neni 16

16.1. Vendimin për sistemimin e mjeteve të realizuara në pajtim me nenin 15 paragrafi 3 të këtij ligji, e miraton MEF-i në afat prej 30 ditësh.

16.2. Pjesa e mjeteve, të cilat në pajtim me vendimin nga paragrafi 1 të këtij neni i takojnë buxhetit të Kosovës, nuk kanë karakter të të hyrave të Lotarisë së Kosovës dhe në të njëjtat nuk përllogaritet tatimi përkatës.

16.3. Lojërat e fatit sipas ligjit, mund të organizohen edhe në bashkëpunim me lotaritë e shteteve të tjera dhe me organizata të tjera të specializuara.

16.4. MEF-i jep pëlqimin për organizimin e lojërave të fatit nga paragrafi 3 i këtij neni.

16.5. Lojërat e fatit të përcaktuara me këtë ligj, Lotaria e Kosovës mund t'i realizojë në bashkëpunim afarist me subjektet e tjera juridike–tregëtare, zejtare, hoteliere të regjistruara, ndër të tjera, edhe, për qarkullimin e mallrave dhe të shërbimeve.

16.6. Lotaria e Kosovës mund të jetë anëtare e EL (EUROPEAN LOTTERIES) European State Lotteries and Toto Association si dhe i asociacioneve të tjera ndërkombëtare të lojërave të fatit.

III LOJËRAT KLASIKE TË FATIT I. Rregullat e lojërave klasike të fatit.

Neni 17

17.1. Me rregullat e lojërave të fatit, të cilat i miraton organizuesi i lojërave të fatit, rregullohen të drejtat dhe detyrimet e organizuesit dhe të pjesëmarrësit në lojërat e fatit.

17.2. Rregullat e lojës së fatit të Tombolles – Bingo në lokale të mbyllura, të cilën e ushtron subjekti juridik tjetër, i miraton dhe i lejon MEF-i.

17.3. Kushtet për ushtrimin e lojës së caktuar të fatit, përcaktohen me rregullat e lojës, të cilat për çdo tip të lojës i miraton organizuesi.

Neni 18

Rregullat për ushtrim të lojës klasike të fatit, detyrimisht duhet të përmbajnë:

- a. emrin dhe selinë e organizuesit;
- b. emrin, përshkrimin dhe kohëzgjatjen e lojës së fatit;
- c. kushtet për bashkëpjesëmarrje në lojën e fatit;
- d. vendin në të cilin organizohet loja, përkatësisht territorin ku bëhet shitja e tiketave;
- e. çmimin individual të tiketës, përkatësisht të kombinacionit;
- f. afatin e fundit për pjesëmarrje në lojë;
- g. sasinë dhe vlerën monetare të emisionit të tiketave;
- h. lartësinë e fondit dhe llojin e fitimeve;
- i. përshkrimin e tiketës dhe të fletëpagesës;
- j. menyrën, procedurën dhe mbikëqyrjen e tërheqjes, përkatësisht menyrën e verifikimit të fitimeve;
- k. menyrën e publikimit të shumave të fondit fitues dhe rezultateve të lojës;
- l. menyrën dhe afatin e pagesës së fitimeve monetare;
- m. menyrën e njohjes së pjesëmarrësit në lojë me rregullat e lojës dhe
- n. procedurën në rastin e revokimit të tërheqjes.

Neni 19

19.1. Rregullat e lojërave klasike të fatit, nuk bënë të ndryshohen pasi të fillojë shitja e tiketave, përkatësisht pagesa e xhiros së caktuar.

19.2. Organizatori i lojës klasike të fatit, është i detyruar që rregullat për lojërat e fatit t'i shpallë publikisht para fillimit të lojës së fatit në shtypin ditor, si dhe personave të interesuar për të marrë pjesë në lojë në vendet shitëse, t'ua vejë në dispozicion rregullat për pjesëmarrje në lojë.

2. Tërheqja e fitimeve

Neni 20

20.1. Në lojërat klasike të fatit, në të cilat kombinacionet fituese vërtetohen nëpërmjet tërheqjes, tërheqja duhet të bëhet para Komisionit prej së paku 3 anëtarëve të cilin e emëron organizuesi.

20.2. Tërheqja e fitimeve duhet të bëhet në mbikëqyrjen e personit të autorizuar nga Ministria për Ekonomi dhe Financa.

20.3. Para fillimit të tërheqjes të lotarisë klasike, organizatori duhet të vërtetojë numrin e tiketave të shitura, ndërsa tiketat e pashitura duhet t'i vulosë para Komisionit dhe personit nga paragrafi 2 i këtij neni.

20.4. Ministria për Ekonomi dhe Financa, nga shkaqet e arsyeshme, sipas kërkesës së organizuesit, mund të lejojë ndërrimin e vendit të tërheqjes së fitimeve, ose të ditës së tërheqjes, por jo më gjatë se 15 ditë.

20.5. Organizatori, ndërrimin e vendit apo shtyrjen e datës së tërheqjes së fitimeve, duhet ta publikojë në të njëjtën mënyrë në të cilën janë publikuar rregullat për organizimin e lojërave klasike të fatit.

20.6. Nëse bëhet shtyerja e tërheqjes së fitimeve, organizatori mund të vazhdojë shitjen e tiketave deri në ditën e caktuar për tërheqje.

20.7. Organizatori i lojës klasike të fatit, mund të revokojë organizimin e lojës së fatit, të xhiros apo të serisë për të cilën ka filluar shitja e tiketave, vetëm atëherë kur MEF-i jep pëlqim – me kusht që blerësve të mëparshëm t'ua kthejë pagesat.

Neni 21

21.1. Gjatë tërheqjes së tiketave, anëtarët e Komisionit dhe i autorizuari i Ministrisë, bëjnë procesverbal dhe atë e nënshkruajnë, e i cili së paku duhet të përmbajë vendin dhe kohën, mënyrën e tërheqjes së fitimeve, numrin e tiketave të shitura, përkatësisht pagesën e përgjithshme në xhiro apo në seri, kombinacionet fituese të tërhequra si dhe vërejtjet e mundshme të dhëna nga pjesëmarrësit në lojë.

21.2. Procesverbali nga paragrafi 1 i këtij neni i dërgohet MEF-it, brenda 7 ditësh nga dita e tërheqjes së fitimeve.

21.3. Raportin për rezultatet e tërheqjes apo për caktimin e fitimeve, organizatori duhet ta shpallë publikisht menjëherë, por jo më vonë se 7 ditë nga dita e tërheqjes së fitimit.

3. Fondi i fitimeve dhe pagesat

Neni 22

22.1. Fondi i fitimeve në lojërat klasike të fatit, përcaktohet nga baza të cilën e bënë vlera e përgjithshme e emisionit të tiketave apo vlera e përgjithshme e pagesave për bashkëpjesëmarrje në loto, Prognozen Sportive - Toto, Tombolë TV- bingo dhe në Tombolën bingo në lokale të mbyllura.

22.2. Shuma e fondit të fitimeve në lojën e caktuar sipas xhirove të caktuara apo lojërat serike të fatit, duhet të publikohen para tërheqjes së fitimeve.

22.3. Fondi i fitimeve në lojërat e caktuara të fatit, përkatësisht në xhiron e caktuar apo në serinë e lojërave të fatit, duhet të jetë së paku 50% nga baza e paragrafit 1 të këtij neni dhe paguhen në pajtim me rregullat e lojërave të fatit.

22.4. Fondi i fitimeve për Tombolë – Bingo në lokale të mbyllura përcaktohet në shumën fikse prej 60% për çdo ciklus të lojës.

Neni 23

23.1. Pagesa e fitimit monetar, përkatësisht tërheqja e fitimeve të llojeve të tjera të lojërave klasike të fatit, ushtrohet në afatin e përcaktuar me rregullat e lojës me atë që nuk mund të jetë më i gjatë se 60 ditë nga dita e shpalljes së raportit për rezultatin e lojës së fatit.

23.2. Shërbimi kompetent i Lotarisë së Kosovës dhe Komisioni të cilin e përcakton Bordi, e bënë evidencimin e saktë të numrit dhe të shumës së përgjithshme të fitimeve të papaguara për secilën lojë të fatit.

23.3. Mjetet nga paragrafi 2 i këtij neni, duhet t'u kthehen lojtarëve nëpërmjet rritjes së fondit për fitime nga loja konkrete apo lojërat e tjera të fatit.

23.4. Për dinamikën e pagesave të mjeteve nga ky nen, vendos Kryetari i Bordit Drejtues të Llotarisë së Kosovës dhe për vendimin në fjalë e njofton MEF-in.

4. Shtypja e tiketave dhe fletëzave

Neni 24

24.1. Tiketat (të mallit, monetare, të mallit-monetare), tiketat e tombollës dhe vërtetimet e tjera për pjesëmarrje në lojë, pos tiketave ekspres dhe tiketave të lotarisë ekspres dhe instant, mund të shtypen vetëm në shtypëshkronja të autorizuara nga MEF-i, sipas propozimit të Bordit drejtues të Lotarisë së Kosovës.

24.2. Tiketat e lotarisë ekspres dhe lotarisë instant mund t'i shtypë shtypëshkronja që i plotëson këto kushte:

- a. kur bëhet fjalë për prodhuesin eminent që punon, përkatësisht shtyp; për një numër më të madh të organizatave të lotarisë që janë anëtare të barabarta të EUROPEAN LOTTERIES dhe kur
- b. prodhuesi i zgjedhur me kontratën për punën konkrete garanton së paku saktësinë e fondit të fitimeve, numrin e kontraktuar të tiketave fituese dhe jofituese dhe sistemimin e tyre, cilësinë e prodhimeve nëpërmjet sigurisë dhe cilësisë së emisionit dhe garanton fshehtësinë e të dhënave.

24.3. Vendimin për zgjedhjen e shtypëshkronjës nga paragrafi 2 i këtij neni, e miraton Kryetari i Bordit Drejtues të Llotarisë së Kosovës.

5. Lotaria

Neni 25

25.1. Lotaria sipas strukturës së fondit fitues mund të jetë lotari e mallit, lotari monetare apo lotari monetare – e mallit.

25.2. Lotaria sipas mënyrës së tërheqjes së fitimeve, mund të jetë klasike me datën e saktë të caktuar për tërheqje, apo, ekspres dhe instant, te të cilat fitimi shtypet në tiketë.

6. Loto, keno dhe varianta të lojërave të tjera

Neni 26

26.1. Loto është lojë klasike e fatit në të cilën tërheqja e numrave fitues të lotos bëhet me topëza dhe nëpërmjet mekanizmave elektronikë, e cila në pajtim me rregullat e kësaj loje, paraqet kombinimin fitues.

26.2. Tërheqja e numërave fitues të lotos bëhet publikisht drejtpërdrejt në transmetim televiziv.

26.3. Topëzat për Loto, Keno dhe për varianta të tjera të këtyre lojërave, duhet të jenë të atestuara nga prodhuesit e tyre në pajtim me rregullat për lojërat e fatit.

7. Prognoza Sportive – Toto.

Neni 27

27.1. Prognoza Sportive – Toto është lojë e fatit që bazohet në prognozimin e rezultateve të garave futbollistike të ligave vendore apo të jashtme që bëhen një herë apo disa herë në javë.

27.2. Varësisht nga oferta mund të bëhet kombinimi i çifteve, e në raste të jashtëzakonshme, prognozimi i gjysmëlojës së parë dhe të dytë të njëjtës ndeshje.

8. Sistemi automat

Neni 28

28.1. Sistemi automat është lidhje telekomunikative e numrit më të madh të automatëve për lojëra të fatit me qëllim të formimit të JACK-POT-tit unik me shanse të njëjta dhe të njëkohëshme të të gjithë pjesëmarrësve në lojë.

28.2. Lotaria e Kosovës, si organizatore ekskluzive e kësaj loje, ka të drejtë që në sistem të ndërlidhë maksimalisht 600 aparate.

28.3. Lotaria e Kosovës është e detyruar që të sigurojë lidhje të hapur (On line) me Ministrinë për Ekonomi dhe Financa me qëllim të qasjes së vazhdueshme të organit kompetent në lartësinë e qarkullimit të realizuar dhe të tërheqjes së Jack-Potit.

28.4. Llojin dhe karakteristikat e automatit, me vendim të veçantë i përcakton Qeveria e Kosovës me propozim të Lotarisë së Kosovës dhe të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

28.5. Shërbimet telekomunikative bien në barrën e Lotarisë së Kosovës.

28.6. Lartësia e Jack-Potit dhe përqindja e fitimit në lojërat individuale në sistemin e automatit, normohen me rregullat e kësaj loje të fatit.

28.7. Organizatori i lojërave të fatit, anëtarët, partnerët, të punësuarit si dhe personat e tjerë që punojnë për organizatorin, janë të obliguar që ta ruajnë fshehtësinë për lojtarët dhe për pjesëmarrjen e tyre në lojë.

28.8. Nëse punëtorët e organeve kompetent të administratës, gjatë ushtrimit të punëve të veta, mësojnë për faktet që ju nenshtrohen fshehtësisë janë të obliguar për t'i ruajtur siç ruhet sekreti zyrtar.

9. TV Tombola – Bingo

Neni 29

29.1. Tombola TV–Bingo është lojë e fatit në të cilën numrat tërheqën publikisht nëpërmjet transmetimit televiziv të drejtpërdrejtë.

29.2. Organizimi i Tombolles TV–Bingo është e drejtë ekskluzive e Lotarisë së Kosovës.

29.3. Tërheqjen e fitimeve në transmetimin e drejtpërdrejtë televiziv mund t'a bëjë vetëm Lotaria e Kosovës.

10. Tombolla – bingo në lokale të mbyllura.

Neni 30

30.1. Tombola Bingo në lokal të mbyllur është lojë e fatit, të cilën e organizojnë subjektet juridike të tjera në bazë të lejës së MEF-it.

30.2. Lejën nga paragrafi 1 të këtij neni, për një vit e jep organi kompetent me kusht që parashtruesi i kërkesës të jetë:

- a. i regjistruar për ushtrim të Tombolës - Bingo,
- b. pronar i pajisjeve të domosdoshme për ushtrimin e Tombolës Bingo
- c. të ketë siguruar lokal përkatës me adresë të caktuar,
- d. të ketë mundësuar qasje fizike të lojtarëve në lokalin në të cilin organizohet loja dhe i cili nuk gjendet në afërsi të drejtpërdrejtë të objekteve fetare, historike apo arsimore dhe që i ka rregullat e lojës bashkë me instrumentet e kontrollit efikas.

30.3. Organizatorit e Tombolës – Bingo në lokal të mbyllur nuk mund të bashkohen me qëllim të ushtrimit të përbashkët të kësaj loje në territorin e dy apo më shumë komunave.

30.4. Organizatori i Tombolës – Bingo në lokal të mbyllur mund të vëjë në qarkullim vetëm tiketa tombole të publikuara nga Lotaria e Kosovës. Tiketatat e tombollës mund të shitën ekskluzivisht si dhe të distribuohen vetëm në lokalin në të cilin organizohet loja.

30.5. Çmimi i tiktetës së tombolës është unik për tërë territorin e Kosovës dhe caktohet nga MEF-i me propozim të Lotarisë së Kosovës.

30.6. Lotaria e Kosovës mund t'i jep tiketa vetëm organizuesit që ka leje nga MEF-i për organizimin e Tombolës – Bingo në lokale të mbyllura.

30.7. Lotaria e Kosovës është e detyruar që për secilin organizues të Tombolës – Bingo në lokale të mbyllura të mbajë evidencë për sasinë dhe serinë e tiketave të dhëna. Rezultati përfundimtar i lojës evidencohet çdo ditë për çdo lojë veç e veç në formular të veçantë (bordero).

30.8. Tombola – Bingo në lokal të mbyllur mund të organizohet disa herë brenda javës dhe në pajtim me rregullat e lojës.

IV. LOJËRAT E VEÇANTA TË FATIT

1. Rregullat e lojërave të veçanta të fatit

Neni 31

31.1. Për çdo lloj të lojërave të veçanta të fatit, miratohen rregulla në pajtim me zakonet e mira afariste dhe ato zbatohen në bazë të lejës së MEF-it.

31.2. Rregullat e lojërave të veçanta të fatit, për çdo lloj loje i miraton organizuesi i tyre.

31.3. Rregullat e lojërave të veçanta të fatit, duhet të jenë të hartuara në gjuhët zyrtare që zbatohen në Kosovë.

31.4. Gjatë lojërave të fatit, të cilat lojtarët i kanë filluar pas pagesës së shumave për pjesëmarrje në një lojë, rregullat e lojërave të fatit nuk mund të ndryshohen, e as të plotësohen deri në përfundimin e saj.

Neni 32

32.1. Qasja në Kasino dhe në klube për lojërat e fatit në automate dhe në vendet ku bëhet bast, është e lejuar vetëm për personat madhorë, të cilët e tregojnë identitetin e vet.

32.2. Personat e uniformuar kanë qasje vetëm gjatë ushtrimit të shërbimit të vet, ose, në saje të pëlqimit të Drejtorisë së kasinos.

32.3. Vizitorëve të kasinos nuk u lejohet sjellja e ndihmesave teknike, të cilat janë të përshtatshme që tu mundësojnë atyre apo të tjerëve përparësi në lojë.

2. Fondi i fitimeve dhe pagesa

Neni 33

33.1. Fondi i fitimeve të lojërave të veçanta të fatit nuk caktohet më parë.

33.2. Automati për lojërat e fatit duhet të jetë i programuar ashtu që të sigurojë pagesën minimale prej 70% nga pagesa e përgjithshme në periudhën tre mujore në të cilën nuk është përfshirë rreziku nga basti në fitimin e realizuar.

33.3. Në kasino, fondi i fitimit nuk caktohet.

33.4. Lloji dhe lartësia e fitimit paguhet në vendin e lojës pas secilit qark të lojërave.

33.5. Kur në fund të orarit të punës, inkasimet e përgjithshme janë më të larta se pagesat, ai ndryshim paraqet fitimin, ndërsa, në të kundërtën, e paraqet humbjen e Kasinos.

3. Lojërat në kasino

Neni 34

34.1. Kasino është lokal i destinuar për organizim të lojërave të veçanta të fatit, të cilat organizohen në tavolinat për lojë me topëza, kubëza apo me letra (siç është ruleti, boules, chemin d'err ferr, black Jack , trente quarante, baccarat , carps etj) (terme standarde)

34.2. Kasino përbehet nga pjesa për loje, pjesa hoteliere dhe pjesa ndihmëse.

Neni 35

Lojërat e veçanta të fatit në kasino, mund t'i organizojë Lotaria e Kosovës. Pas Lotarisë së Kosovës, lojërat e fatit në kasino mund t'i organizojnë edhe subjektet ekonomike të regjistruara ekskluzivisht për ushtrimin e veprimtarisë së tillë. Për subjektet ekonomike, po qëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe, zbatohen dispozitat ligjore, të cilat i referohen veprimtarisë së tyre.

Neni 36

36.1. Lartësia e kapitalit themelues të subjekteve ekonomike të organizuara si kompani, korporata etj, nuk mund të jetë më e ulët nga lartësia e rezervës fillestare të sigurimit.

36.2. Shuma monetare e rezervës fillestare të sigurimit nuk mund të jetë më e ulët se 2.000.000 euro, me përjashtim të Lotarisë së Kosovës.

36.3. Ministria për Ekonomi dhe Financa, për çdo vjet e cakton shumën nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 37

Ministria për Ekonomi dhe Financa jep leje për regjistrim të subjekteve ekonomike, nëse subjekti:

- a. paraqet prova që e ka bërë pagesën e pjesës monetare të kapitalit themelor dhe të rezervës fillestare të sigurimit në konton e caktuar nga MEF-i;
- b. paraqet kontratën për themelimin e saj me të dhënat për themeluesit, lartësinë e depoziteve, emrin dhe thirrjen e themeluesve me dokumentet valide për pasurinë e paluajtshme të themeluesve;
- c. siguron instrumentin për të drejtën e pengut në pasurinë e themeluesve të cilin e cakton Ministria për Ekonomi dhe Financa, ose garancionin bankar në shumën të cilën e cakton Ministria.
- d. paraqet elaboratin për themelimin dhe afarizmin e kasinos;
- e. paraqet rregullat për punën e kasinos dhe i paraqet rregullat për secilën lojë të fatit të cilën do ta ushtronte në kasino.

Neni 38

38.1. Për ushtrimin e lojërave në kasino, Lotaria e Kosovës, përkatësisht subjekti ekonomik duhet t'i plotësojë këto kushte:

- a. kasino duhet të gjendet në lokale të veçanta apo në objekte hoteliere së paku me katër yje;
- b. të posedojë prova se është bashkëpronarë i lokaleve ose kontraktor për shfrytëzimin e lokaleve për lojë, ashtu që, me pjesën hoteliere dhe me lokalet ndihmëse, bënë hapësirën e një tërësie hapësinore dhe funksionale, me atë që, sipërfaqja nuk mund të jetë nën 500 m²;
- c. punëtorët ti ketë të aftësuar për punë në kasino dhe t'i flasin së paku dy gjuhë botërore dhe janë në marrëdhënie pune të rregulltë;
- d. është miratuar Rregullorja për punë e kasinos si dhe rregullat për çdo lloj të lojës që organizohet në kasino;
- e. të ketë së paku 3 tavolina, arkën, këmbimorën dhe e ta ketë të siguruar mbikëqyrjen audio – vizuele me incizim të rregulltë;
- f. në pajtim më ligjin ka mbikëqyrje të hyrjeve dhe të daljeve bashkë me sigurimin dhe mbrojtjen trupore të lojtarëve dhe të vizitorëve;
- g. të ketë hapësirë të veçantë për ruajtjen e parave dhe të sendeve me vlerë.

38.2. Provat nga paragrafi I i këtij neni, i prezenton organizuesi dhe ato i vlerëson MEF-i.

Neni 39

39.1. Ministria për Ekonomi dhe Financa detyrohet që brenda 60 ditëve nga dita e parashtrimit të kërkesës për leje, të merr vendim me të cilin vendos për kërkesën e subjektit ekonomik.

39.2. Në afatin e paraparë nga paragrafi I i këtij neni, Ministria duhet të vlerësojë bonitetin dhe ligjshmërinë si dhe rregullsinë e afarizmit të deriatyshëm të subjektit ekonomik, përkatësisht të pronarit të subjektit ekonomik.

39.3. Leja jepet për periudhën dy vjeçare. Organizatori është i detyruar që pas parashtrimit të kërkesës për vazhdimin e lejes, të paraqes raportin për afarizmin e vet gjatë vitit të mëparshëm. Nëse rezultati afarist të cilin e vlerëson MEF-i nuk është i kënaqshëm, kërkesa mund të refuzohet.

39.4. Me aktvendimin me të cilin jepet leja për ushtrimin e lojërave të fatit në kasino, jepet edhe pelqimi për rregullat e lojërave të veçanta, të cilat organizohen në kasino.

Neni 40

Subjekti ekonomik është i detyruar për ta filluar ushtrimin e veprimtarisë së vet, më se voni brenda 15 ditësh nga dita e regjistrimit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

Neni 41

41.1. Mjetet e rezervave fillestare të sigurimit, kanë karakter të sigurimit të fitimeve dhe shfrytëzohen kur shpenzohen të gjitha mjetet e tjera, të cilat i ka organizatori .

41.2. Nëse mjetet e rezervave fillestare pakësohen nën 50%, organizuesi e ndërpre punën e vetë.

41.3. Nëse organizuesi brenda afatit prej 30 ditësh nga dita kur rezervat fillestare janë pakësuar nën 50%, nuk e bënë plotësimin e mjeteve të rezervave fillestare të sigurimit, leja për ushtrimin e lojërave të fatit, abrogohet, ndërsa subjekti ekonomik fshihet nga evidenca e regjistrimit, ashtu që në atë rast, fillimisht bëhet inkasimi i detyrimeve të tij në favor të buxhetit të Kosovës.

Neni 42

42.1. Çdo objekt i kasinos duhet të ketë të instaluar mbikëqyrjen video të atestuar dhe të vënë në funksion që nga fillimi dhe të ndërpret atëherë kur mbaron orari i punës.

42.2. Paragrafi I i këtij neni u referohet lojërave të fatit të tipit “Lojërat e Gjalla” në kasino, përkatesisht Ruletit, Black Yack etj, në të cilat, drejtpërdrejt dhe vazhdimisht marrin pjesë punëtorët e punësuar në Kasino.

42.3. Organizatori është i detyruar, që shënimin në video, ta ruajë në vend të sigurt së paku, shtatë ditë nga dita e xhimit.

Neni 43

43.1. Ne objektin e Kasinos mund të jenë të pranishëm një apo me shumë anëtarë të organit mbikëqyrës të ngarkuar për mbikëqyrje përkritazi me zbatimin e këtij ligji.

43.2. Personat nga paragrafi I i këtij neni janë nënshkrues të detyrueshëm të bordero-s, si dhe të dokumenteve të tjera të caktuara me Rregulloren për punën e kasinos, të cilën, në procedurë të caktuar, e miraton MEF-i.

43.3. Kasino duhet të ketë lokal të ndarë për ofrimin e shërbimeve hoteliere në të cilin shërbehen pije të tipit Kafe-Bar, por, mund të ketë edhe objekt hotelier të tipit Restoran.

43.4. Kushtet për hyrje në Kasino i cakton bartësi i lejës, me atë që individëve të caktuar, apo grupeve të individëve të caktuara, mund t’ua ndalojë hyrjen pa dhënë shpjegime për atë vendim.

43.5. Lojtarëve, të cilët gjatë lojës cenojnë rregullat e caktuara për lojë normale, mund t’u ndalohet vazhdimi i lojës.

4.Lojërat në automate dhe klube të veçanta

Neni 44

44.1. Lojërat e veçanta të fatit në automate në klube të veçanta, mund të organizohen vetëm në automate dhe në instrumente të tjera për lojëra të fatit me mundësi të depozitit të shumëfishtë dhe të fitimit të shumëfishtë (multiplayer) në klube me më së paku 20 automate. Ky paragraf nuk ka të bëjë me Lotarinë e Kosovës.

44.2. Automati për lojë të fatit është aparat që vëhet në lëvizje me hudojen e zhetonit, me çelës apo me teledirigjues.

44.3. Vënia e automatit në lëvizje kushtëzohet me pagesën paraprake në funksion të realizimit të fitimit në të holla, i cili varet ekskluzivisht nga rasti.

44.4. Lojërat e fatit në automate mund t'i organizojë Lotaria e Kosovës si dhe subjektet ekonomike të regjistruara ekskluzivisht për lojëra të fatit të këtij lloji.

Neni 45

Numrin e përgjithshëm të klubeve në të cilat organizohen lojëra të fatit në automate të cilat mund të veprojnë në territorin e Kosovës, propozohen nga Bordi Drejtues, pëlqimin e jep MEF-i, ndërsa e cakton Qeveria e Kosovës.

Neni 46

46.1. Ushtrimi i lojërave të fatit nëpërmjet automateve në klubet e veçanta ushtrohet nga subjektet ekonomike, të cilat i kanë selitë e veta në Kosovë dhe i plotësojnë kushtet ligjore dhe kanë leje të MEF-it.

46.2. Ministria për Ekonomi dhe Financa, subjekteve ekonomike u jep leje për ushtrimin e këtyre lojrëve të fatit kur:

- a. janë të regjistruara për ushtrimin e atyre lojërave të fatit
- b. janë pronarë të automateve;
- c. kanë siguruar lokale përkatëse për vendosje të së paku 20 automateve me atë që të mos ndodhen në afërsi të drejtpërdrejtë të objekteve dhe të institucioneve fetare, historike apo arsimore;
- d. kanë miratuar rregulla për lojëra të fatit dhe
- e. kanë vërtetuar se, automatet janë të konstruara dhe të përshtatura për sigurimin e fitimit nga 70% të pagesave të përgjithshme në të cilat nuk është përfshirë lidhja me kusht me lojë vazhduese “më të madhe apo më të vogël”.

46.3. Pos kërkesave nga paragrafi 2 i këtij neni, parashtruesi i kërkesës i nënshtrohet vlerësimit të Ministrisë përkitazi me lokalitetin e objektit afarist në të cilin vendosen aparatet, pronësinë e automateve si dhe për ligjshmërinë dhe rregullsinë e afarizmit dhe të sjelljeve të deriatyshme.

46.4. Aktvendimi me të cilin jepet leja për ushtrimin e lojërave të fatit nëpërmjet automateve për lojëra të fatit në klubet e posaçme, njëherit paraqet edhe pëlqimin e Ministrisë për ushtrimin e veprimtarisë.

Neni 47

47.1. Gjatë lojërave në automate ndalohet përdorimi i çfarëdo mjete ndihmës apo i çfarëdo instrumenti në funksion të realizimit të fitimit, ndryshe, organizuesi është i detyruar për të penguar pagimin e tyre.

47.2. Leja jepet për një vit me numër të caktuar dhe me lloj të automateve si dhe me lokacion të precizuar të tyre. Para skadimit të afatit, subjekti ekonomik duhet të bëjë kërkesë për vazhdimin e lejës.

47.3. Më kërkesën për vazhdimin e lejës, subjekti ekonomike duhet të paraqes edhe raportin për afarizmin e vet gjatë vitit të mëparshëm. Nëse rezultatet afariste, sipas vlerësimit të MEF-i, nuk janë të kënaqshme, kërkesa mund të refuzohet.

Neni 48

48.1. Automatet dhe tavolinat për lojërat e fatit, para vënies në përdorim, duhet të jenë të rregullta teknikisht.

48.2. Në përdorim nuk mund të vëhen automatet për lojëra të fatit të cilat janë të vjetra mbi 5 vjet nga dita e prodhimit me atë që kjo nuk u referohet automateve legale të deriatyshme.

48.3. Automatet për lojëra të fatit që vëhen në përdorim, duhet të kenë orë elektronike dhe bazë për informatat automatike (regjister total) për regjistrim dhe sigurim të të dhënave për punën e përgjithshme të automateve duke përfshirë edhe stabilimentin mekanik kontrollues, i cili e bënë shënimin e qarkullimit të automatit.

48.4. Kushtet dhe mënyrat e shënimeve dhe të incizimeve të qarkullimit, me udhëzim të veçantë, i përcakton MEF-i.

Neni 49

49.1. Para vënies në përdorim të automatit për lojërat te fatit, bëhet kontrollimi teknik i tij dhe për të jepet certifikata për rregullsinë apo për parregullsinë e tij. Para kontrollimit të automatit që për herën e parë vëhet në përdorim, subjekti juridik që e vë në përdorim, personit të autorizuar për kontrollim teknik, duhet t'i prezentojë certifikatën dhe garancionin e prodhuesit të automatit.

49.2. Kontrollimi teknik i automatit për lojëra të fatit mund të bëhet nga subjektet juridike që nuk ushtrojnë lojëra të fatit apo nuk japin automate hua në përdorim në bazë të autorizimit të veçantë të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa.

49.3. Certifikata për rregullsinë e automatit për lojëra të fatit jepet për një vit dhe duhet të sigurohet para skadimit te afatit një vjeçar.

Neni 50

50.1. Në përdorim mund të jenë automatet dhe tavolinat për lojërat e fatit po qe se në to, në vende të dukshme vëhen tregues të veçantë për shënimet dhe regjistrimet e informatave për llojin e instrumentit, lokacionin, afatin dhe numrin serik si dhe për organizuesin e lojërave.

50.2. Organizuesi i lojërave të fatit, fletëngjitëset për të dhënat nga paragrafi I i këtij neni, në procedurë të caktuar, i merr nga Administrata Tatimore. Për fletëngjitëset e bëra, të dhëna dhe në dispozicion, Administrata Tatimore mban evidencë të veçantë.

Neni 51

51.1. Organizuesi i lojërave të fatit, para vënies në përdorim të automatit apo të tavolinës ose para transferimit të tyre, me kohë dhe në mënyrë të përshtatshme duhet të bëjë njoftim për organin e autorizuar për dhënie të lejës dhe, atë shtatë ditë para ndërmarrjes së veprimit të tillë.

51.2. Automati për lojëra të fatit duhet të jetë i konstruktuar dhe i përshtatur në atë mënyrë që, në numrin e përgjithshëm të kombinimeve të programuara, lojtarëve t'ua paguajë së paku 70% nga vlera e pagesave të tyre dhe, atë, në përiudhën tre mujore, në të cilën nuk përfshihet rreziku i lidhjeve me kusht në fitimin e realizuar ndaj shënimeve të hyrjeve dhe të daljeve nëpërmjet treguesit mekanik.

5. Basti

Neni 52

52.1. Basti për rezultatet sportive dhe për ngjarjet e pasigurta (lidhja me kusht), është lojë e veçantë e fatit.

52.2. Bastet e ndryshme mund t'i organizojë Lotaria e Kosovës si dhe subjektet ekonomike me seli në Kosovë të regjistruara për lojëra të bazuara në bast.

52.3. Subjektet ekonomike mund të organizojnë baste të ndryshme në lokale, posaçërisht të përshtatura për to dhe në bazë të lejës nga MEF-i.

Neni 53

53.1. Organizuesi i lojës së bastit duhet t'i plotësojë këto kushte:

- a. të jetë shfrytëzues legal i lokalit në të cilin organizohet basti;
- b. t'i ketë së paku dy vende për pranimin e pagesës;
- c. vendi për pagesa dhe shënimi qendror kompjuterik, duhet të jenë telekomunikativisht të ndërlidhur;
- d. organizuesi i bastit duhet të jetë pronar i pajisjeve të nevojshme për ushtrimin normal të bastit dhe të ketë provë për pagesën e kapitalit themelor në konton e caktuar.

53.2. Leja për ushtrimin e bastit, subjektit ekonomik i jepet për një vit dhe, ajo, duhet të përtrihet para skadimit të afatit njëvjeçar.

53.3. Subjekti ekonomik është e detyruar që më kërkesën për vazhdim të lejës, të prezantojë edhe raportin për afarizmin e vetë gjatë vitit të mëparshëm. Kur rezultatet afariste, sipas vlerësimit të MEF-it nuk janë të kënaqshme, kërkesa për leje mund të refuzohet.

53.4. Organizuesi i bastit është i detyruar që për kushtet e ushtrimit të lojës së fatit – bastit, të caktojë rregulla përkatëse.

Neni 54

54.1. Subjektit ekonomik të cilit i jepet leja për ushtrimin e bastit, duhet të ketë kapital themelor-financiar në shumë prej së paku 300.000 euro.

54.2. Me qëllim të sigurimit të pagesës së fitimeve në favor të lojtarëve dhe të plotësimit të detyrimeve ligjore e kontraktuese, organizuesi i lojërave të mbështetura në bast, gjatë periudhës së lejimit për ushtrimin e bastit, në konton e caktuar, duhet të ketë të paguar së paku 50% të vlerës së kapitalit themelor-financiar.

Neni 55

55.1. Pajisjet telekomunikative mund të jenë:

- a. rrjetë i hapur (One Line), ose
- b. rrjetë gjysëm i hapura (Semi One Line)

55.2. Organizuesi i lojërave të fatit të bastit, që ka rrjetë të hapur, në vendin ku bëhet pagesa nuk është i detyruar që ta ketë shiritin kontrollues.

55.3. Organizuesi i lojërave të bastit që nuk ka rrjetë të hapur, është i detyruar që në vendin ku bëhet pagesa, të ketë shiritin kontrollues.

V. KOMPENSIMET PËR USHTRIMIN E LOJRAVE TË FATIT

Neni 56

56.1. Për dhënien e lejës për ushtrimin e lojërave të fatit, të lejës për rregullat e lojës së fatit, për vazhdimin e lejës për ushtrimin e lojërave të fatit dhe për hapje të lokalit të ri, bëhet pagesa e kompensimeve të caktuara.

56.2. Kompensimet nga paragrafi I i këtij neni i paguhen buxhetit të Kosovës.

56.3. Kompensimet nga paragrafi I i këtij neni paguhen për:

1. Lejën e ushtrimit të veprimtarisë:

- (1) në automate në klube të veçanta
 - a. për lejën e hapjes së klubit 25.000 euro
 - b. për 20 automate 5.000 euro
 - c. për çdo automat tjetër 250 euro
 - d. për vazhdimin e lejës 2.500 euro.
- (2) në kasino
 - a. për leje të hapjes së kasinos 1.000.000 euro
 - b. për lëjimin e rregullave të një loje 500 euro
 - c. për lëjimin rregullave të punës së kasinos 500 euro
 - d. për vazhdimin e lejës. 50.000 euro.

- (3) në bastor
- a. për dhënie të lejës 25.000 euro
 - b. për lejimin e rregullave të lojës 500 euro
 - c. për hapje të çdo lokalit tjetër të ri 5.000 euro
 - d. për vazhdimin e lejës 2.500 euro.
- (4) Tombolla – bingo ne lokale të mbyllura
- a. për leje të ushtrimit të lojës 5.000 euro
 - b. për lejimin e rregullave të lojës 250 euro.
 - c. për vazhdimin e lejës 2.000 euro

56.4. Pa provë për pagesën e kompensimit përkatës nga paragrafi 3 i këtij neni, nuk mund të jepet leja, as nuk mund të fillohet puna.

56.5. Kompensimet nga paragrafi 1 i këtij neni nuk kanë të bëjnë me Lotarinë e Kosovës.

Neni 57

57.1. Me propozim të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, Qeveria vlerëson dhe e përcakton shkallën e kontributeve të cilën Lotaria e Kosovës do të derdhë në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për :

- a. çështje të invalidëve të luftës dhe të punës;
- b. kujdesin për fëmijët e dëshmorëve, fëmijet me të meta dhe pa prindër;
- c. ndihmë për të drejtat e njeriut;
- d. ndihmë për zhvillimin e kulturës;
- e. zhvillimin e sportit;
- f. ndihmë për mbrojtjen e shëndetit si dhe për çështje humanitare të nevojshme në momentin dhe rrethanat e caktuara.

57.2. Pagesat dhe kontributet nga paragrafi 1 i këtij neni, Lotaria e Kosovës i përcakton në pajtim me udhëzimin administrativ të nxjerrë nga MEF-i.

VI. MBIKËQYRJA

Neni 58

58.1. Mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji e bënë Ministria për Ekonomi dhe Financa.

58.2. Lotaria e Kosovës dhe subjektet ekonomike që ushtrojnë lojëra të fatit në kasino, janë të detyruara që të mundësojnë mbikëqyrjen e tërë procesit material dhe financiar në baza ditore.

58.3. Organi nga paragrafi 1 i këtij neni, ka të drejtë që, gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes, vetë apo nëpërmjet nëpunësit të autorizuar, të bëjë kontrollimin e lokaleve afariste dhe të gjitha procedurave që kanë të bëjnë me ushtrimin e lojërave të fatit, të pajisjeve, pjesëve të mjeteve ndihmëse për ushtrimin e lojërave të fatit, të instrumenteve për mbikëqyrje të ushtrimit të lojërave të fatit, të instrumenteve audio dhe video dhe të mjeteve ndihmëse, të librave afariste, raporteve, evidencave dhe dokumenteve të tjera, si dhe të dhënave që e mundësojnë vërtetimin e gjendjes faktike.

VII. DISPOZITA NDESHKIMORE

Neni 59

59.1. Subjektet ekonomike që organizojnë lojëra të fatit pa leje të organit kompetent, varësisht nga lloji i lojës së fatit gjobiten prej 35.000 deri 70.000 euro.

59.2. Me dënim me të holla në shumën prej 5.000 euro deri 25.000 euro, subjektet ekonomike që ushtrojnë lojëra të fatit, gjobiten kur:

- a. ushtron lojëra të fatit në kundërshtim me këtë ligj dhe dispozita ligjore;
- b. ndryshon rregullat e xhiros se caktuar apo të serisë klasike të lojës të fatit, pasi që, ka filluar shitja e tiketave të lojërave të fatit të xhiros, përkatësisht të serisë në fjalë dhe, kur pa leje të caktuar, e shtyn ditën apo e ndërron vendin e tërheqjes së fitimeve;
- c. bënë tërheqje të fitimeve pa prani të nëpunësit të autorizuar të MEF-it apo para tërheqjes nuk e vërfikon numrin e tiketave të shitura, ndërsa tiketat e pashitura nuk i mbyllë, nuk i vulosë dhe nuk i anulon para komisionit;
- d. nuk i paguan fitimet në afatin e përcaktuar me rregullat e lojës;
- e. përdorë topëza të cilët nuk kanë atest përkatës nga prodhuesi i tyre;
- f. gjatë ushtrimit të lojërave të fatit, angazhon në sistem mbi 600 automate;
- g. vënë në qarkullim kartela tombolle, të cilat nuk i ka emituar Lotaria e Kosovës;
- h. vazhdon ushtrimin e lojërave të fatit, edhe pse, nuk e plotëson cilindo nga kushtet e kërkuara për ushtrimin të lojërave të veçanta të fatit në kasino dhe në klube automate si dhe kur
- i. në rastin e ushtrimit të mbikëqyrjes, organit të autorizuar nuk ia mundëson shikimin e dokumentacionit afarist, të lokaleve afariste, të mjeteve ndihmëse, të instrumenteve apo e pamundëson mbikëqyrjen e afarizmit financiar-material të tërsishëm.

59.3. Për kundravajtje nga paragrafi 1 i këtij neni, personi përgjegjës në subjektin juridik gjobitet (dënohet me të holla) në shumën prej 250 € deri 2.500 €.

VIII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 60

60.1. E drejta e fituar për ushtrimin e lojërave të fatit, përkatësisht, për lejen e ushtrimit të lojërave të fatit, nuk mund të bartet në subjektin tjetër juridik.

60.2. Subjektet ekonomike të cilat organizojnë lojëra të fatit në bazë të lejës së dhënë deri në hyrje në fuqi të këtij ligji, mund të vazhdojnë punën më kusht që në afatin prej 60 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji të bëjë përshtatjen e punës së vet, si dhe të akteve afariste me dispozitat e këtij ligji.

Neni 61

Ministria për Ekonomi dhe Financa, në procedurë të caktuar, me qëllim të zbatimit të këtij ligji, brenda 60 ditësh nga dita e miratimit të tij, do të nxjerrë Udhëzim administrativ rreth zbatimit të këtij ligji.

Neni 62

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, pushojnë së aplikuari të gjitha dispozitat e mëparshme të referuara lojërave të fatit në Kosovë.

Neni 63

Ky Ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe në ditën e shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Ligji Nr.2004/35
8 shtator 2004

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

akademik Nexhat Daci